



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VII

Sesioni vjeshtor

**Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 01 .**

Prishtinë, më 24.2.2020 në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: kryetare e komisionit- Miljana Nikoliq, zëvendëskryetar: Duda Balje dhe Fetah Rudi, anëtarët e tjerë: Ivan Todosjiviq, Zoran Mojsiloviq, Igor Simiq, Milosh Peroviq, Fidan Brina Jilta, Albert Kinolli, Etem Arifi, Veton Berisha, Adem Hodzha, Rasim Selmanaj dhe Arbër Rexhaj.

Munguan: Elmi Reçica, Ljubinko Karaxhiq dhe Hajrullah Qeko.

Pjesëmarrës tjerë: përfaqësues nga OSBE-ja; Senad Karaahmetoviq dhe Anila Kadiu; Dafina Maxhuni KDI-i; Doruntina M. dhe Biondina Çanta nga Kuvendi i Republikës së Kosovës; Pleurat Rudi EUSR; Rozafë Thaçi – QKSS, dhe Celal Iliaz, Drejtorja për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit, koordinatorë - Natasha Prica-Tishma, zyrtare e lartë ligjore- Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Miljana Nikoliq**, kryetare e komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua:

Randi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Mbledhja konstituive;**
- 3. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës.

Miljana Nikoliq, kryetare e komisionit, anëtare e Listës Serbe-LS, me theks të veçantë tha se ndihet e privilegjuar që kryeson Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, njëherit përshëndet përzgjedhjen e anëtarëve të këtij komisioni.

Kryesuesja konstatoi se rendi i ditës u miratua njëzëri, pa ndryshime.

Kryesuesja- fjalën iu dha për prezantim, anëtarëve të komisionit.

Duda Balje, zëvendëskryetare e parë e komisionit, mandati i tretë i saj. Është e vetëdijshme për rendësin që ka ky komision, andaj në bazë të vullnetit të mirë do t'i shtyjë përpara çështjet me interes vital të komuniteteve.

Fetah Rudi, zëvendëskryetar i dytë i komisionit, anëtarë i GP-LDK-së, për herë të parë deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës. Uron punë të mbarë duke besuar se do të ketë frymë të mirë bashkëpunimi sa i përket trajtimit të çështjeve për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të komuniteteve

Arbër Rexhaj, anëtar i GP-VV, uron suksese në përbërjen e këtij komisioni. Mendon se do të ketë pajtim të plotë në koordinim të kolegjalitetit, dhe secili nga ne do t'i kryej punët me përgjegjësi. Theksoi se angazhimi i tij do të jetë konstruktiv në funksionalizimin e adresimit të drejtë dhe me përgjegjësi të drejtave dhe interesave të komuniteteve

Fidan Brina Jilta, anëtare e GP 6 +, përshëndet anëtarët e komisionit duke ju uruar punë të mbarë. Është legjislacioni i parë i saj si deputete e Kuvendit të Kosovës. Mendon se secili deputet në këtë komision do të ofrojë kontribut në të mirë të komunitetit të vet.

Etem Arifi, anëtar i komisionit, theksoi se do të angazhohet për ngritjen e çështjeve që ndërlidhen me interesat e të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë.

Rasim Selamanaj, anëtarë i GP – AAK-së, është mandati i tretë i tij. Shpreh qëndrimin e tij se do të afrojë kontribut të duhur, me qëllim që të mbrohen të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Veton Berisha, deputet i zgjedhur për herë të tretë në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Në dy mandatet e kaluar ka qenë anëtar i Komisionit për Komunitete, ku ka dhënë mendimet dhe sugjerimet e tija konkrete. Edhe në këtë mandat, nuk do të mungojë angazhimi i tij dhe se do të japë maksimumin për trajtimin e çështjeve që i përkasin komuniteteve që jetojnë dhe veprojnë në Kosovë.

Ivan Todosijeviq, anëtar i Listës Serbe – LS, theksoi se do të angazhohet në realizimin e të drejtave dhe detyrave që bartë ky komision.

Milosh Peroviq, anëtarë i Listës Serbe – LS, shpreh gatishmëri në përmbushjen e detyrimeve dhe përgjegjësi, në mënyrë që puna jonë të dalë me suksese të duhur.

Adem Hoxha, anëtarë i GP-6+, dëshiron mbarëvajtje në punën e cila do të zhvillohet në këtë komision. Shpreh qëndrimin e tij se do të përkrahë procedurat të cilat ndërlidhen në interesat e të gjitha komuniteteve.

Albert Kinolli, anëtarë i GP 6+, iu dëshiron mbarëvajtje në punë për deputetët që kanë qenë anëtarë në legjislacionet e mëhershme dhe deputetëve të rinj. Në fjalinë e tij tha se do të afrojë maksimumin lidhur me çështjet të cilat kërkojnë trajtim të duhur për komunitetet që jetojnë në Kosovë.

2. Mbledhja konstituive

Kryesuesja theksoi se Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve, është Komisioni i Përherëshëm. Në kuadër të fushëveprimit të tij të punës dhe përgjegjësi që ka, komisioni shqyrton çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Ajo, shpalosi në detaje kompetencat e bazuara në fushëveprimin dhe përgjegjësitë e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, të përcaktuara me shtojcën 2.1 të Rregullores për punën e Kuvendit të Republikës së Kosovës:

Fushëveprimi i këtij komisioni përfshin:

- Shqyrtimi i projektligjeve nga aspekti i të drejtave dhe interesave të komuniteteve
- E drejta e anëtarëve të tij për të vendosur me shumicën e votave në lidhje me projektligjet, me qëllim të adresimit të drejtë dhe me përgjegjësi të drejtave dhe interesave të komuniteteve. Një deklaram i tillë duhet dërguar komisionit përkatës funksional të Kuvendit, ose Kuvendit, sipas rastit;
- E drejta për të propozuar projektligje dhe masa tjera të ngjashme, në kuadër të përgjegjësi të Kuvendit, kur e konsideron si të nevojshëm për trajtimin e problemeve të komuniteteve;
- E drejta që në kërkesë të një anëtari të Kryesisë së Kuvendit që secili projektligj t'i dërgohet për shqyrtim Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, Komisioni me shumicën e votave të anëtarëve, vendos të paraqesë amendamente në projektligj;
- Dhënia e mendimeve këshilluese me kërkesë të Kryesisë së Kuvendit, një komisioni apo një grupi të përbërë prej së paku 10 (dhjetë) deputetësh të Kuvendit, në lidhje me një çështje;
- Shqyrton projektbuxhetit dhe rishikimin e buxhetit të ministrisë së resorit përkatës dhe i rekomandon Komisionit për Financa dhe Buxhet shqyrtimin dhe miratimin e tij në Kuvend.
- Mbikëqyrë zbatimin e të ligjeve nga fushëveprimi i tij; dhe
- Çështjet tjera të cilat me vendim të Kryesisë i barten këtij komisioni.

Gjatë kryerjes së funksioneve të tij, Komisioni bashkëpunon me ministrinë e resorit përkatës dhe me të gjitha ministritë e tjera nga të cilat mund të kërkojë informata specifike, përfshirë raporte të drejtpërdrejta nga ministrat ose personat e tjerë përgjegjës, kur kërkohen nga komisioni.

3. Të ndryshme

Kryesuesja, në pikën në të ndryshme ajo hapi çështjen e aktivitetit të komisionit, siç është:

- *Hartimi i Planit të Punës së Komisionit për vitin 2020, i cili do të përcaktojë aktivitetet kryesore në bazë të cilave puna e komisionit do të bazohet në çështjet që janë në kompetencën e tij.*

Në fjalinë e saj tha se komisioni do t' i ushtrojë veprimtaritë e saja duke u mbështetur në Rregulloren e punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Strategjinë Legjislative të Qeverisë, për vitin 2020. Në kuadër të marrjes së strategjisë së Qeverisë, komisioni do të hartojë Planin dhe Programin e punës, me të gjitha aktivitetet e punës për periudhën janar- dhjetor 2020.

Veton Berisha mendon se është mirë të vazhdoen proceset që janë nisur në mandatin e kaluar e të cilat kanë mbetur të pa përfunduara. Qeveria, në mandatin e kaluar, ka ndarë fondin buxhetor në vlerë prej 2.500,00 euro, për ndërtimin e shtëpive për komunitetin joshumicë, i cili fond nuk ka arritur të monitorohet.

Ai theksoi se në takimin e radhës, do të dalë me kërkesë që të formohet GP, lidhur me monitorimin e implementimit të projektit për ndërtimin e shtëpive për komunitetin joshumicë.

Duda Ballje pajtohet me propozimin e dhënë nga parafolësi z. Berisha. Si kërkesë e saj konkret ishte që të formohet edhe GP, për monitorimin e punës së ministrit të MKK, i cili ka për obligim të raportojë lidhur me sigurimin e informatave të nevojshme dhe të cilat janë në interes të komuniteteve.

Fidan Brina Jilta parashtronjë si kërkesë që fushëveprimtaria e komisionit të përkthehet në gjuhën turke, dhe njëherit falënderohet për mirëkuptim.

Anëtarët e komisionit folën lidhur me caktimin e ditës për mbajtjen e mbledhjeve të rregullta të komisionit. Kryesuesja theksoi se përbërja e këtij komision është në numër të madh dhe se është vështirë të vendosim për një ditë që është e përshtatshme për të gjithë anëtarët.

Pas diskutimeve kryesuesja, konstatoi se mbledhjet e rregullta të komisionit do të mbahen ditën e martë, në orën 10:00.

Mbledhja përfundoi në orën 10:30.

*Përgatitur nga;
Njësia mbështetëse e komisionit*

Kryetare e komisionit,

Miljana Nikoliq